



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 27.05.2019 (Raportimi i Prokurorisë së Përgjithshme).

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi dhe Ediola Braha.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Ftohet media të jetë e pranishme.

Përsëritet të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të komisionit, pasi kuorumi është i plotë për të vazhduar me trajtimin e çështjeve që kemi në rendin e ditës. Sot, në fakt, do të zhvillojmë dy mbledhje të Komisionit të Ligjeve.

Në pjesën e parë të ditës kemi pesë çështje, ndërsa në pjesën e dytë do të bëjmë një mbledhje tjetër, pasi edhe aty kemi për të trajtuar tri çështje të tjera.

Fillojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 27.05.2019, i cili, besoj, ju ka ardhur në rrugë elektronike.

Biem dakord? Ka vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore është kolegja Aurora Mara.

Ka konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave zoti Elton Haxhi, zëvendësministër.

Zoti Haxhi, mirë se keni ardhur në komision!

Do t’ju lutesha të bëni shkurtimisht një prezantim të kësaj marrëveshjeje për kolegët e mi të komisionit. Pastaj do t’ia kaloj fjalën relatores dhe më pas kolegëve për pyetje.

Zoti Haxhi, fjala është për ju.

Elton Haxhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin” është një nga shumë marrëveshjet e tjera, të cilat vendi ynë i ka lidhur me vende të tjera.

Aktualisht, kjo është marrëveshja e 44-ërt. Marrëveshje të miratuara, të ratifikuara dhe të nënshkruara kemi 43. Duhet theksuar fakti se të gjitha këto marrëveshje hartohen duke u bazuar në një model të pranuar nga Organizata Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim

(OECD), e cila ka krijuar një kuadër të përgjithshëm se si nënshkruhen këto marrëveshje; edhe marrëveshja që po nënshkruajmë, bazohet në parimet që ka përcaktuar OECD-ja.

Marrëveshja, siç shpjegohet edhe në titullin e saj, ka për synim shmangien e tatimit të dyfishtë. Bëhet fjalë për rastet kur një rezident i një shteti kryen aktivitet në një shtet tjetër: si për ne, si për Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Në raste të tilla, në qoftë se nuk ka një marrëveshje, mund të ndodhë që ky person të taksohet edhe në shtetin ku përfiton të ardhurat, edhe në shtetin ku ka rezidencën tatimore. Në mënyrë që kjo gjë të shmanget, pra qoftë individit ose biznesi të mos taksohen dy herë, atëherë në marrëveshje parashikohet se cili shtet e ka të drejtën e taksimit: në disa raste e ka shteti, ku burimi i të ardhurave krijohet, ndër në disa raste të tjera e ka shteti, ku është rezidenca e biznesit ose e individit, por ka edhe raste të tjera kur ndahet e drejta për ta taksuar.

Siç e thashë, kjo marrëveshje shmang tatimin e dyfishtë.

Gjithashtu, marrëveshja ka dispozita, në bazë të të cilave shtetet kontraktore shkëmbejnë informacione dhe bashkëpunojnë për parandalimin e evazionit fiskal për subjekte që kanë aktivitet në të dyja vendet.

Marrëveshjet kanë një rol të rëndësishëm në kompleksitetin e faktorëve që garantojnë, favorizojnë dhe stimulojnë marrëdhëniet ekonomiko-tregtare ndërkombëtare, konkretisht ndërmjet të dyja vendeve, për të cilat bëhet fjalë në këtë marrëveshje. Rëndësia e tyre po rritet vazhdimisht në kushtet e rritjes së aktiviteteve të biznesit, shoqërive shumëkombëshe dhe në kushtet e rritjes së vazhdueshme të lëvizjes së lirë ndërkombëtare të njerëzve, kapitaleve, mallrave dhe burimeve financiare.

Në përmbyllje, pa u futur në shumë detaje, sepse, siç e thashë, të gjitha detajet janë të përcaktuara nga OECD-ja, marrëveshja është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 350, datë 23.05.2012, ndërsa në datën 06.02.2019 është nënshkruar në Riad të Arabisë Saudite gjatë vizitës së delegacionit shqiptar atje. Sot ne po e shqyrtojmë në komision për t'u ratifikuar më tej në parlament dhe, pasi të ratifikohet edhe nga pala saudite, do të hyjë në fuqi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhi!

Zonja Mara, do t'ju lutesha të na njihnit shkurtimisht me gjetjet e relacionit.

Aurora Mara – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Si relatore, do të them dy fjalë lidhur me marrëveshjen.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”, i paraqitur për shqyrtim, është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 (pika 1) dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të nderuar kolegë, para jush keni relacionin, marrëveshjen, si dhe vendimin nr. 305, datë 15.05.2019 të Këshillit të Ministrave.

Siç e shpjegoi edhe zoti zëvendësministër, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje luan një rol të rëndësishëm në kompleksin e marrëdhënieve ekonomiko-tregtare ndërmjet të dyja vendeve. Duke pasur aktivitet të dyja shtetet ose, duke qenë rezident i njërit shtet, që siguron të ardhura në shtetin tjetër, individit ose subjekti juridik mund të rëndohet në tatim të dyfishtë, gjë që mund të krijojë premisa për shmangien e tatimeve dhe të evazionit fiskal.

Kjo marrëveshje trajton pikërisht faktin se si do të shmanget tatimi i dyfishtë, duke i dhënë të drejtën për tatimin e të ardhurave të caktuara vetëm njërit shtet apo duke e ndarë këtë të drejtë ndërmjet të dyja shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë.

Marrëveshja është e përbërë nga 30 nene, në të cilat specifikohen të gjitha procedurat për realizimin e bashkëpunimit të kësaj marrëveshjeje.

Siç u tha edhe nga parafolësi, marrëveshja është miratuar me vendimin nr. 350 të vitit 2012 të Këshillit të Ministrave dhe është nënshkruar nga palët më 06.02.2019 në Riad të Arabisë Saudite.

Për sa i përket aspektit ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Për sa i përket aspektit procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, në cilësinë e relatores, e vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Në fakt, e vlerësoj marrëveshjen e sjellë për ratifikim për shmangien e tatimit të dyfishtë, por kam dy pyetje.

E para: a ka vende të tjera, me të cilat lind nevoja e nënshkrimit të marrëveshjeve të tilla, të cilat stimulojnë bashkëpunimin ekonomiko-tregtar, por shmangin edhe evazionin fiskal?

E dyta: pse është zgjedhur pikërisht Mbretëria e Arabisë Saudite? Rritja e numrit të bashkëpunimeve, transaksioneve, numri i punonjësve është i konsiderueshëm?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Për sa i përket pyetjes së parë, siç e thashë në fillim të fjalës sime, kemi vetëm 43 marrëveshje, nga të cilat ne nuk mbulojmë ende as Bashkimin Europian. Pra, në mos gaboj, kemi gjashtë vende të Bashkimit Europian, me të cilat nuk kemi ende marrëveshje. Thënë kjo, prioritet për ne, në kushtet kur aspirojmë për t'u integruar, këto pesë ose gjashtë vende të Bashkimit Europian do të jenë prioritet për periudhën në vijim, pasi duhet të kemi marrëveshje me të pesta këto vende. Përveç këtyre pesë vendeve, kemi edhe shumë vende të tjera, me të cilat nuk kemi marrëveshje.

Nuk është e thënë të kemi marrëveshje me të gjitha vendet, sepse, zakonisht edhe kjo marrëveshje, e cila është iniciuar, iniciohet gjatë bisedimeve për bashkëpunimet tregtare, që zhvillojnë delegacionet e të dyja vendeve. Është sjellë si kërkesë e njëres palë. Nuk jam në gjendje t'ju them kush e ka sjellë si kërkesë, por besoj se e ka sjellë shteti tjetër, jo ne.

Është sjellë si kërkesë që të lidhet një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe nuk vjen si rrjedhojë e shtimit të marrëdhënieve tregtare, por ndoshta është parë si parakusht për shtimin e marrëdhënieve tregtare. Ama, duke pasur në konsideratë edhe shkëmbimet dypalëshe në kuadër të vizitave, vërejmë një fluks të shtuar të vizitave, me qëllim bashkëpunimin tregtar, qoftë nga vizita e Kryeministrit gjatë nënshkrimit me një ekip nga qeveria, qoftë edhe nga vizita para një muaji e një delegacioni nga Arabia Saudite lidhur me investimet e huaja dhe çështjet tregtare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhi!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, vijojmë me votimin në parim të kësaj projekt marrëveshjeje.

Kush është dakord në parim? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim me një votë kundër projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të këtij projektligji.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me dy vota kundër.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me dy vota kundër.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi me dy vota kundër projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

Raporti i Komisionit të Ligjeve t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Zoti Haxhi, shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe bankës Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi dhe Ediola Braha.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi – Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilda Malile – Drejtoreshë pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Brikena Jazxhi – Specialiste e Sektorit të Huamarrjes në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe bankës Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji do të jetë kolegu Adnor Shameti.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Energjetikës, zoti Ilir Bejtja, zëvendësministër, zoti Enea Karakaçi, drejtor, zonja Ilda Malile, drejtoreshë pranë OSHEE-së, si dhe zonja Brikena Jazxhi, e cila vjen nga Sektori i Huamarrjes në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Zoti Bejtja, ju lutem, na bëni një prezantim të kësaj projekt marrëveshjeje.

Pastaj do t’ia kaloj fjalën kolegut Adnor Shameti për të bërë edhe një prezantim të gjetjeve si relator.

Zoti Bejtja, fjala është për ju.

Ilir Bejtja – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Përshëndetje!

Marrëveshja vjen si marrëveshje huaje pas miratimit që më parë i keni bërë akordit ndërqeveritar për nënshkrimin e një marrëveshjeje huaje prej 30 milionë eurosh për sistemin e shpërndarjes, për eficiencën energjetike të tij.

Kjo kredi është e shoqëruar nga një grant prej 2 milionë eurosh, i cili do të shërbejë për asistencë teknike për zbatimin e projekteve, që përfshihen në këtë kredi, në këtë hua.

Huaja vazhdon të jetë e butë. Në fakt, është një hua ndryshe nga të hua të tjera, që kanë qenë në kuadrin e marrëveshjes akord ndërmjet dy qeverive të nënshkruara në vitin 2009, është direkt me bankën gjermane KfW, madje do të thosha që është një sukses, sepse, për herë të parë, vetë sistemi elektroenergjetik mund të nënshkruajë marrëveshje pa ndërmjetësimin e qeverisë shqiptare.

Si marrëveshje e tillë, duke qenë se implikon garanci sovrane, duhet të miratohet edhe në parlament.

Për të hyrë më në thelb të marrëveshjes, janë disa nënstacione, disa linja për t’u rinovuar, bashkë me një pjesë të sistemit automatik të komandimit (SKADA) për dy zona pilot,

që janë Durrësi dhe Tirana, projekte të cilat janë definuar që më herët në vitin 2016 dhe, tashmë, me përmirësimin e performancës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ne kemi gjetur mundësi dhe hapësira nëpërmjet shlyerjes së kredive të mëparshme pa i lëvizur tavanet e buxhetit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Pak a shumë, kjo është kredia. Nëse ju duhen më shumë detaje për projektet, jam gati.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Bejtja!

Unë po ia kaloj fjalën zotit Shameti për të bërë një prezantim të gjetjeve, si relator.

Adnor Shameti - Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse edhe zëvendësministri i linjës e parashtrori para komisionit, ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, dhe Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet KfW, Frankfurt am Main, për një hua me kushte të favorshme në shumën prej tridhjetë milionë eurosh, e cila do të përdoret për financimin e projektit “Për programin e investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Programi do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët në Shqipëri.

Konkretisht, me anë të fondeve të akorduara nga kjo marrëveshje, do të realizohen komponentët e mëposhtëm:

- Komponenti i parë do të realizojë dhe do të krijojë një sistem kontrolli mbikëqyrës dhe të përpunimit të të dhënave, do të krijojë një sistem menaxhimi të shpërndarjes, një sistem të shpërndarjes së ngarkesës, një qendër të kontrollit të shpërndarjes, si dhe sisteme të tjera të integruara të teknologjisë së informacionit.

- Komponenti i dytë do të përfshijë rehabilitimin dhe/ose ndërtimin e nënstacioneve të përzgjedhura 110 kV dhe 20 kV, duke përfshirë kapacitetin e transmetimit në nënstacionet e mbingarkuara, si dhe zgjerimin e voltazhit të mesëm të nënstacioneve ekzistuese.

- Komponenti i tretë do të përfshijë përshtatjen e rrjetit me voltazh të mesëm në nivelin 20 kV në zonat e përzgjedhura (Durrësi dhe Tirana).

Si relator i projektligjit, do të sugjeroja që në tekstin dhe në titullin e projektligjit të hiqen si të panevojshme shkurtime: “huamarrësi”, “agjencia e zbatuese e projektit” “OSHEE” dhe KfW, pasi këto shkurtime jepen në tekstin e marrëveshjes bashkëngjitur projektit dhe e ngarkojnë artificialisht atë. Këto sugjerime janë çështje të teknikës legislative dhe nuk e cenojnë thelbin e marrëveshjes.

Përfundimisht, në aspektin ligjor, e vlerësoj në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Si relator, e vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojnë atë në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është pro?

Kush është kundër? 2 kundër

Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”.

Kalojmë në votimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1, zoti Shameti, meqë patët sugjerime të teknikës legjislative për nenin 1, a jeni dakord me propozimin e relatorit për të hequr shkurtime?

Kush është pro?

Kush është kundër? 2 kundër

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1. Kalojmë te neni 2.

Kush është pro?

Kush është kundër? 2 kundër

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Kush është kundër? 2 kundër

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj. Raporti përkatës i Komisionit të Ligjeve t'i çohet komisionit përgjegjës e më pas, seancës plenare për votim.

Shumë faleminderit, zoti Bejtja dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave për prezencën në komision!

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i raportit vjetor për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për vitin 2018

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi dhe Ediola Braha.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, në miratimin e raportit vjetor për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për vitin 2018. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Çyrbja.

Para se t'ia kaloj fjalën relatorit, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve që ky raport do të miratohet në Komisionin e Ligjeve dhe do t'i përcillet për dijeni Kryetarit të Kuvendit dhe seancës plenare.

Unë po ia kaloj fjalën zotit Çyrbja për të bërë një prezantim të raportit vjetor për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për vitin 2018. Ky raport vjen si sintezë jo vetëm e materialit që është paraqitur në komision nga ATP-ja, por edhe pas seancës dëgjimore, që ne kemi zhvilluar me drejtoreshën e kësaj agjencie.

Fjala për ju, zoti Çyrbja!

Jurgis Çyrbja - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Në mbledhjen e datë 6 maj 2019 Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mori në shqyrtim raportin periodik për veprimtarinë e Agjencisë së Trajtimit të Pronës për vitin 2018, duke organizuar për këtë qëllim seancën dëgjimore, ku ishin të pranishëm përfaqësues të Agjencisë së Trajtimit të Pronës dhe përfaqësues të Avokaturës së Shtetit.

Përpara jush është paraqitur është paraqitur për shqyrtim dhe miratim draft-raporti “Për shqyrtimin e raportit periodik vjetor të Agjencisë së Trajtimit të Pronave dhe vlerësimin e veprimtarisë së saj për vitin 2018” në të cilën janë detajuar gjetjet e veprimtarisë së ATP-së për vitin 2018, si dhe rekomandimet që duhet të mbahen në konsideratë nga ky institucion për vitin 2019.

Sjell në vëmendjen tuaj, se në zbatim të Kreut II, “Detyrimi i institucioneve të veçanta të administratës qendrore për raportim në Kuvend”, të vendimit të Kuvendit nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, në rastin e institucioneve të veçanta të administratës qendrore, që raportojnë në Kuvend, bazuar në ligjet e tyre të posaçme (siç është rasti i ATP-së), komisioni parlamentar përgjegjës, organizon seancat dhe përgatit në çdo rast një raport për çështjet e trajtuara dhe propozimet për zgjidhje.

Pas miratimit të raportit komisioni vendos ose që raporti t'i përcillet për shqyrtim dhe miratim seancës plenare, i shoqëruar me projektrezolutën përkatëse, ose të vërë në dijeni Kryetarin e Kuvendit, i cili e njofton në seancën plenare më të parë.

Bazuar në praktikën e mëparshme për vlerësimin e veprimtarisë së ATP-së, në vitet 2016 - 2017, në cilësinë e relatorit, vlerësojmë se ky raport pas miratimit nga Komisioni duhet t'i njoftohet Kryetarit të Kuvendit dhe të publikohet në faqen e Kuvendit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka diskutime për raportin? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e raportit të komisionit për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për vitin 2018.

Kush është pro?

Kush është kundër? 1 kundër

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet raporti vjetor për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për vitin 2018.

Të njoftohet Kryetari i Kuvendit dhe të vihet në dijeni edhe seanca plenare, edhe deputetët e tjerë të Kuvendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2018”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi dhe Ediola Braha.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, në shqyrtimin dhe miratimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2018”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Vasilika Hysi.

Tekstin e projektrezolutës e keni të gjithë mbi tryeza, por për të bërë një prezantim për opinionin publik dhe për mediet, ia jap fjalën kolegës Vasilika Hysi. Më pas, nëse do të ketë pyetje dhe komente në lidhje me tekstin e projektrezolutës, jemi të hapur.

Fjala është për ju, zonja Hysi!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare në një mbledhje të përbashkët patën mundësinë të dëgjojnë në raport Prokuroren e Përgjithshme në detyrë. Njëkohësisht, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pati mundësi të dëgjojë edhe raportin e ministres së Drejtësisë, lidhur me zbatimin e rekomandimeve parësore të KM-së për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018 që, sipas legjislacionit në fuqi, i përcillet Prokurorit të Përgjithshëm nga ministrja e Drejtësisë dhe është kjo e fundit, që e monitoron zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Në hartimin e kësaj projektrezolute janë mbajtur parasysh 3 aspekte:

1. Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvendin e Shqipërisë për gjendjen e kriminalitetit, veprat penale, numrin e tyre dhe politikën penale.
2. Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvendin e Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave.
3. Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvendin e Shqipërisë për zbatimin e rezolutës që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar për veprimtarinë e këtij institucioni një vit më parë.

Pikërisht, edhe në hartimin e kësaj projektrezolute kemi mbajtur parasysh 3 aspektet për të cilat Prokurori i Përgjithshëm është i detyruar të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë.

Gjithashtu, në hartimin e kësaj projektrezolute kemi pasur parasysh edhe funksionet e reja që ka Prokurori i Përgjithshëm. Ai nuk ka më kompetenca në lidhje me hetimet, procedimet, politikën penale që zbaton një prokuror apo një prokuror tjetër. Në nenin 38 të ligjit të ri për organizimin e prokurorisë, ai ka për detyrë të nxjerrë udhëzime të përgjithshme

me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, por jo për Prokurorinë e Posaçme, e cila pritet të krijohet.

Prokurori i Përgjithshëm ka për detyrë të kontribuojë edhe në përmirësimin e statistikave të njehsuara në fushën e drejtësisë, që i raporton në Ministrinë e Drejtësisë, e cila është kompetente për hartimin e vjetarit të statistikave;

Bazuar sa më sipër në pjesën e parë të rezolutës, pasi Kuvendi i Shqipërisë njeh kompetencat e reja që ka Prokurori i Përgjithshëm, në pjesën e dytë kalohet në një analizë shumë të përgjithshme bazuar në këtë raport lidhur me kriminalitetin dhe format e shfaqjes së tij për vitin 2018, duke dhënë në paragrafin e parë tendencën ose totalin e kallëzimeve të trajtuara nga organi i prokurorisë krahasuar me një vit më parë.

Në paragrafin e dytë është dhënë një analizë e të dhënave të kriminalitetit sipas procedimeve penale të organit të prokurorisë. Gjithmonë flasim për llojet e veprave penale më të përhapura.

Një vështrim lidhur me gjininë e të pandehurve nga këndvështrimi i gjinisë, i arsimit, i gjendjes sociale, i banimit dhe i gjendjes gjyqësore.

Padyshim, në raport ka edhe shumë tregues të tjerë, por të paktën këta tregues janë të domosdoshëm për të krijuar një tablo të përgjithshme të kriminalitetit, të tendencave, të autorëve apo të pandehurve të përfshirë në të.

Në një paragraf më vete analizohet efektiviteti i politikës penale të ndjekur nga organi i prokurorisë për numrin e çështjeve penale të përfunduara dhe i çështjeve dhe i numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë, i cili është konstatuar se është në rritje në krahasim me vitin 2017, por edhe numri i procedimeve penale të pushuara, i cili është rritur, ndërkohë që numri i mosfillimit të procedimeve penale për kallëzimet dhe i çështjeve të pezulluara, është ulur. Pra, në një paragraf është dhënë një tablo apo një konstatim, lidhur me politikën penale dhe efektivitetin e organit të prokurorisë.

Elementi i tretë, i rëndësishëm në rezolutë, është konstatimi lidhur me zbatimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe se si janë zbatuar rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë i ka lënë Prokurorit të Përgjithshëm si detyra për t'u zbatuar gjatë vitit 2018.

Janë dhënë disa konstatime. Siç e kemi thënë edhe gjatë diskutimit, kanë qenë 13 rekomandime nga Kuvendi i Shqipërisë, nga të cilat 12 janë përmbushur plotësisht dhe një është përmbushur pjesërisht. Ky është rekomandimi, që ka të bëjë me hetimet pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë kriminel e organizuar, sipas të ashtuquajturit ligji antimafia.

Konkretisht, lidhur me zbatimin e rezolutës, janë evidentuar në rezolutë faktet që lidhen me procedimet e regjistruara për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, numri i të cilave është rritur, ndërsa për veprat e tjera penale në këtë fushë, ka ulje të numrit të procedimeve penale.

Në rezolutë është vlerësuar se hetimet proaktive për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi të narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike janë rritur.

Është vënë në dukje se hetimet pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë krimin e organizuar, sipas ligjit antimafia janë ende në nivele të ulëta dhe ka nevojë të rriten.

Ka vijuar të realizohet nga organi i prokurorisë ndihma në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve sipas detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Është evidentuar forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel qendror dhe vendor dhe me autoritetet e huaja në përgjithësi është rritur, por është theksuar nevoja e rritjes së këtyre bashkëpunimeve. Janë parashikuar në dy paragrafë, bashkëpunimi ndërinstitutional më vete dhe bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore të huaja për të shkëmbyer informacion në një paragraf më vete.

Gjithashtu, në projektrezolutë është evidentuar që politika penale për masat e sigurisë dhe të dënimit për format e veçanta të krimit si: krimi i organizuar, korrupsioni, dhuna në familje, krimet kundër jetës, pastrimi i parave, krimi ekonomik dhe financiar, armëmbajtja pa leje, krimi që lidhet me procesin zgjedhor dhe krimet mjedisore janë ashpërsuar.

Në një paragraf më vete kemi evidentuar rolin që ka luajtur Prokurori i Përgjithshëm apo saktë Sektori i Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike pranë Prokurorinë e Përgjithshme, duke administruar, 185 raste për verifikim të thelluar.

Së fundi, është bërë një lidhje midis raportit të ministrit të Drejtësisë dhe raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave ku vihet theksi te nevoja për të rritur numrin e hetimeve proaktive nga prokurorët lidhur me veprën penale të korrupsionit, të trafikimit të narkotikëve dhe nevojën e rritjes së numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë.

Bazuar në analizën e raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, të raportit të ministrit të Drejtësisë, në progresraportin lidhur me zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për vitin 2019, kemi sugjeruar disa rekomandime për vitin 2019.

Të nderuar kolegë, do të doja dhe do të pranoja të gjitha komentet dhe sugjerimet tuaja për të pasur rekomandime sa më konkrete dhe sa më të mundshme.

Të mos harrojmë që Prokurorja e Përgjithshme në detyrë, nuk ka kompetenca në hetimin e çështjeve konkrete. Për rrjedhojë, në rekomandimet e paraqitura nga faqja 3 deri në faqen 5 janë rekomandime, të cilat synojnë:

Së pari, nxjerrjen dhe hartimin e udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftimin e kriminalitetit për vitin 2019. Pra, Prokurorja e Përgjithshme duhet të nxjerrë udhëzime të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

E dyta, është vënë theksi te nevoja për të vijuar përpjekjet për të rritur hetimet proaktive dhe përdorimin në kufijtë e ligjit të teknikave speciale të hetimit për krimet e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Është theksuar gjithashtu, nevoja për thellimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në gjitha fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor me autoritetet gjyqësore të huaja.

Gjithashtu, meqenëse ne kemi miratuar një ligj të ri për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Policinë Gjyqësore”, kemi kërkuar hartimin e kalendarit të trajnimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, edhe për punonjësit e Policisë Gjyqësore theksi është vënë të mbrojtja më e mirë e të drejtave të viktimave meqenëse në Kodin e Procedurës Penale ka një sërë dispozitash për të cilat Kuvendi ka nevojë të informohet lidhur me zbatimin e të drejtave të viktimave, por, njëkohësisht është evidentuar ose është kërkuar të raportojë në Kuvend lidhur me zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale, për të Mitur, meqenëse kemi një kod të ri dhe ka një sërë angazhimesh për organin e prokurorisë dhe është Prokurori i Përgjithshëm, i cili duhet të hartojë udhëzime të përgjithshme për prokurorët e ngarkuar për hetimin e të miturve.

Bazuar edhe në kërkesat e progresraportit, ajo çfarë është konstatuar në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe në raportimin që bëri ministrja e Drejtësisë, një detyrë e veçantë është lënë lidhur me përpunimin e statistikave të procedimeve penale, veprave penale, të cilat sikurse me të drejtë e tha edhe vetë Prokurorja kanë nevojë të përmirësohen, kemi kërkuar të rishikojë mënyrën e përpunimit të statistikave në lidhje me krimin, me qëllim që të mundësohet jo vetëm vlerësimi i kriminalitetit, të politikës penale, por statistikat e krimit të jenë të krahasueshme me statistikat e krimit të vendeve në rajon në nivel evropian dhe ndërkombëtar. Ne raportojmë në Europol, në Eurostat, në Interpol. Ne kemi nevojë të kemi statistika të besueshme dhe lehtësisht të krahasueshme. I është kërkuar Prokurorit të

Përgjithshëm që të hartojë udhëzime të përgjithshme për përdorimin efektiv të instituteve të reja si: urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë me qëllim që ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, ato që janë hartuar në kuadër të reformës në drejtësi të gjejnë një zbatim më të mirë sesa në vitin 2018.

Së fundi, të nderuar kolegë ne kemi pasur disa shqetësime të ngritura qoftë në raportin e KQZ-së, por edhe në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me zbatimin e ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe kryejnë funksione publike”. Në këtë kuadër, i është kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm hartimi dhe nxjerrja e udhëzimeve me qëllim që të adresojmë problematikat e hasura dhe të unifikojmë praktikat lidhur me zbatimin e këtij ligji për të gjithë funksionarët publikë.

Pa dyshim detyrat që i janë lënë Prokurorit të Përgjithshëm, janë të shumta, por po të shikoni ato kanë të bëjnë me nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme. Veçoria e projektrezolutës është që në zbatim të kërkesave sistematike që kolegu Fino bën sa herë që institucionet e pavarura raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë, pra që të kemi rekomandime konkrete, me afate të matshme për herë të parë në këtë rezolutë kemi parashikuar disa rekomandime dhe afate, për të cilat Prokurori i Përgjithshëm detyrohet të sjellë një raport me shkrim pranë Kuvendit të Shqipërisë, pa pritur raportimin vjetor.

Ju lutem, ju sjell në vëmendjen tuaj që të shikoni rekomandimin 2, ku i kërkohet Prokurorit të Përgjithshëm që brenda muajit nëntor të vitit 2019 të përcjellë në Kuvend, në komisionin tonë një raport me shkrim lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimit për zbatimin e procedurave hetimore për sa u përket hetimeve pasurore, aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara. Pse e kam vënë muajin nëntor dhe pse e kam kërkuar? Sepse Kuvendi do të diskutojë buxhetin në këtë muaj. Do të ishte me shumë interes të dinim se cilat janë vështirësitë në burimet njerëzore, financiare apo edhe për bashkëpunim midis institucioneve të cilat mund ta orientojnë shumë mirë kolegun Fino, që besoj se do të jetë edhe relator i projektbuxhetit për vitin 2010, që kur të diskutojmë nevojat e Prokurorit të Përgjithshëm, të kemi në konsideratë edhe se çfarë është bërë deri në muajin tetor dhe çfarë problemesh ka hasur.

Të nderuar kolegë, ju sjell në vëmendje rekomandimin 4, ku i kemi kërkuar Prokurorit që të përcjellë në Kuvend menjëherë pas miratimit udhëzimet e përgjithshme që miraton. Ne kemi nevojë të dimë në mënyrë sistematike, periodike se cilat janë udhëzimet e nevojshme që Prokurori i Përgjithshëm nxjerr në zbatim të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave me qëllim që të ndërhyjmë në të gjitha institucionet e tjera që raportojnë Kuvend

për t'i nxitur, për t'i inkurajuar ata për bashkëpunim ose për nxitje të problematikave që mund të hasë Prokurori i Përgjithshëm në përmbushjen e rekomandimeve që lë Këshilli i Ministrave dhe të mos presim fundin e vitit, atëherë kur periudha e zbatimit të rekomandimeve ka skaduar.

Të nderuar kolegë, ju sjell në vëmendjen tuaj edhe rekomandimin 7, ku i është kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm që brenda muajit shtator të vitit 2019 të raportojë në Kuvend, në komision, hartimin e një kalendari të trajnimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Ne duam të shikojmë sesi po zbatohet ligji i ri "Për Policinë Gjyqësore" që kemi miratuar. Kjo do të ishte një mënyrë shumë e mirë për ta nxitur, për ta inkurajuar Policinë e Shtetit, por edhe Prokurorinë për hartimin e një kalendari sistematik të trajnimeve. Në këtë mënyrë do të shikojmë edhe nevojat që do të ketë Policia e Shtetit për buxhet apo për të rekomanduar forcimin e bashkëpunimit.

Do të sjell në vëmendjen tuaj edhe rekomandimin 9 për statistikën. E theksojmë nevojën e statistikave se në progresraport theksohet përsëri nevoja e përpunimit të statistikave sipas standardeve ndërkombëtare. Prokurorja e Përgjithshme e kishte shqetësim dhe pranonte dobësinë që kanë statistikën, por nuk mundemi pas kaq shumë vitesh që policia, prokuroria, gjykatat të mos kenë ende një sistem ose një *software* ku përpunimi i statistikave të drejtësisë penale të jetë i tillë, që të analizojmë realisht gjendjen e kriminalitetit, por edhe të jetë i krahasueshëm me kriminalitetin në vendet e tjera.

Do t'ju lutesha që të vini edhe afatin që kam parashikuar në rekomandimin 10, ku i kërkojmë Prokurorit të raportojë në komision brenda muajit dhjetor të vitit 2019 për zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Ka 2 vjet që është miratuar Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ende nuk po zbatohet. Nuk është vetëm përgjegjësi e Prokurorisë, është edhe e Ministrisë së Drejtësisë, e institucioneve të tjera, por Kuvendi i Shqipërisë ka për detyrë ta nxisë dhe ta inkurajojë këtë proces.

E fundit, meqenëse për viktimat ende ka probleme mbrojtja e tyre, është kërkuar marrja e masave për të adresuar mbrojtje më të mirë të viktimave. Brenda muajit nëntor, rekomandimi 11, i kërkojmë Prokurorit të Përgjithshëm të dërgojë një informacion pranë Kuvendit lidhur me zbatimin e masave të reja të parashikuara për mbrojtjen e viktimave. Pse e them këtë? Ju kujtohet që në raportimin që bëri Prokurori i Përgjithshëm kërkoi të kishte 30 koordinatorë për mbrojtjen e viktimave. Me të drejtë zoti Fino, ia miratoi kërkesën, ia dhamë, por janë edhe burimet njerëzore. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është ngritur, Prokuroria e Përgjithshme ka një mbështetje nga institucionet ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave.

Kur Kuvendi ka ratifikuar një sërë marrëveshjes në kuadër të projektit SIDA dhe projekteve të tjera, për mbështetjen e viktimave në përgjithësi dhe të atyre të dhunës në familje në veçanti është koha të kemi një raport të detajuar, sesi kapitulli për mbrojtjen e të drejtave të viktimave parashikuar në Kodin e Procedurës Penale është zbatuar nga viti 2017 deri në vitin 2019. Këto janë rekomandimet, të cilat kanë afate konkrete. Mirëpres çdo koment, sugjerim për përmirësimin e kësaj projektrezolute.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Siç e tha edhe kolegja, rezoluta është e hapur për sugjerime dhe komente gjithmonë në funksion të përmirësimit të saj. Nëse ndonjë nga kolegët ka komente për pika të caktuara të projektrezolutës, është i ftuar të marrë fjalën.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Faleminderit!

Ngaqë u përmenda 3 herë, dua të them se është një projektrezolutë e saktë me afate konkrete. Kam vetëm një sugjerim. Në raportimin që bëri Prokurorja e Përgjithshme unë ngrita një çështje, një pyetje, e gjej të pasqyruar te pika 15 e projektrezolutës. Është fjala për hartimin dhe nxjerrjen e rregullave për informimin e publikut lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale, duke garantuar ruajtjen e sekretit të hetimit dhe ndalimin e publikimit të akteve procedurale penale nga Prokuroria apo nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe kufizimin e hapësirës për spekulim në lajm në lidhje me çështje të caktuara penale dhe manipulimin e opinionit publik nëpërmjet lajmeve të rreme apo keqinformuese. Është një çështje të cilën e trajtova, shumë mirë që është vënë në rezolutë, madje duhej të ishte vënë si pikë më e rëndësishme edhe më përpara, sepse nga kjo gjë vuan Prokuroria sot. Por ajo që dua t'i them zonjës Hysi, është se pika 15 ndoshta duhet të rregullohet edhe me masat që duhet të merren kur nuk garantohet ruajtja e sekretit. Vërtet ajo mund të nxjerrë një rregullore, por edhe Prokuroria duhet të mësohet me masat konkrete kur nuk garantohet ruajtja e sekretit. Të dënohen ata prokurorë që japin të dhënat e një çështjeje që nuk është trajtuar ende në procesin gjyqësor dhe bëhen publike, ndërkohë që nuk është e domosdoshme të bëhet një gjë e tillë. Të merren masat, të mësohet edhe Prokuroria, të kenë çështje penale për veten e tyre kur nuk e ruajnë sekretin shtetëror dhe sekretin e një hetimi. Pra, pika 15, për mendimin tim duhet të rregullohet pak për masat që duhet të merren dhe ta monitorojmë gjatë gjithë vitit në vazhdim. Monitorimin më mirë se me medie do ta bëjmë ne. Kur të ketë çështje sensitive dhe në fund të vitit do të kemi mundësi t'i themi Prokurores së Përgjithshme, kushdo qoftë Prokurori i Përgjithshëm: “Kanë dalë 1, 2, 3 gjëra të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren që kemi realizuar vetë”.

Thjesht dua të rregullohet pika 15 për sa u përket masave që duhet të merren për të garantuar ruajtjen e sekretit.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Kush e do fjalën ? Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të sugjeroj dy rregullime termash, besoj se ka vend. Për shembull në faqen 2, nuk mund të thuhet: “Ka vijuar ndihma në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve”, sepse këtu nuk po flasim për ndihmë, por për detyrë funksionale. Duket sikur Prokuroria po jep ndihmë në këtë proces, por ajo bën detyrën e ngarkuar nga ligji. Mund të ketë edhe vende të tjera, për shembull te pika 2: “Zbatimi i drejtë dhe i njëllojtë i procedurave hetimore” janë terma që nuk i njeh as Kodi i Procedurës. Pra, duhet t’i përshtatim pak pavarësisht se ne jemi organ politik, por duhet të përdorim terminologjinë.

Nga ana tjetër do të sugjeroja që të ishte rekomandim patjetër: “Përmbushja e rekomandimeve të komisionit *ad-hoc*”. Këtu raportoi Komisioni *ad-hoc* i ngritur nga ky komision, nga ky Kuvend dhe ngriti disa shqetësime për rekomandime të pazbatuara nga organi i Prokurorisë, duke drejtuar me gisht edhe organin përgjegjës. Që të mos ndodhë më, duhet që në rezolutën e Kuvendit t’i tërhiqet vëmendja. Së pari, t’i kërkohet bashkëpunim me komisionin *ad-hoc*.

Së dyti, të përmbushë rekomandimet e këtij komisioni. E thashë edhe në mbledhjen tjetër, ai është zëri, veshi i këtij komisioni, i këtij parlamenti, por nuk i dëgjohet zëri se e ka veshin të mbyllur organi përkatës.

Ju lutem, sugjeroj që një pikë e veçantë dhe e fortë të jetë për komisionin *ad-hoc*.

Ulsi Manja - Kush ka sugjerime të tjera?

Zonja Mara.

Aurora Mara- Faleminderit!

Kam vetëm një sugjerim. Jam dakord me zotin Fino, për pikën 15, se gjatë hetimeve dalja e sekretit hetimor është në dëm të madh të hetimeve. Pra, te kjo pikë në momentin e hartimit dhe nxjerrjen e rregullave për informimin e publikut lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale, do të kaloja direkt në pikën: “Duke garantuar ruajtjen e sekretit të hetimeve dhe ndalimin e publikimit të akteve procedurale penale nga prokurori ose oficerët e Policisë Gjyqësore”. Pra, do të evitoja shprehjen: “Për të unifikuar mënyrën e shpërndarjes së informacionit për publikun”.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush nga kolegët ka sugjerime të tjera?

Po, zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj - Unë e ndoqa me vëmendje edhe e lexova, i hodha një sy të shpejtë rezolutës dhe kam disa gjëra në parim.

E para, ne nuk bëjmë rezolutë për Prokuroren e Përgjithshme në detyrë. Kjo është një rezolutë për Prokurorinë. Prokurorja e Përgjithshme në detyrë është pjesë e saj, është drejtuese. Ne kemi 2 orë dhe në logjikën e ligjit, nuk marrim në analizë punën e Prokurorisë, por marrim gjendjen e kriminalitetit. Të krijohet përshtypja se këtu ka dy nonsense.

E para, sikur ne duam të bëjmë një rezolutë për atë zonjën, drejtuesen e Prokurorisë së Përgjithshme në detyrë dhe sikur duam ta bëjmë për Prokurorinë. Jo! Ne e kemi për institucionin e Prokurorisë, për gjendjen e kriminalitetit, që do të thotë se rezoluta duhet të jetë në këtë optikë.

E dyta, në parim, zoti kryetar, kam parë edhe rezolutat e tjera, ndoshta është *per forca*, ose sepse kjo struktura që ka Kuvendi, që nuk është pjesë, por është në mbështetje të komisionit, që ka të bëjë me monitorimin ndoshta duhet të zbatojë një standard, sepse shikoj standarde të ndryshme. Aty bëhet fjalë për rezolutë dhe kjo e fundit në vlerësimin tim duhet të ketë 4 komponentë.

Komponenti i parë është ai i vlerësimit në parim.

Komponenti i dytë janë konstatime lidhur me zbatimin e rezolutës së mëparshme të Kuvendit. Ne jemi Kuvendi dhe kemi bërë një rezolutë. Komisioni përgjegjës, secili nga komisionet përgjegjëse të Kuvendit ka për detyrë t'i thotë seancës plenare: "Ne e kemi monitoruar dhe në përfundim na rezulton se nga zbatimi i rezolutës së vitit të kaluar janë 1, 2, 3 gjëra"; konstatimet në raport me ligjin dhe në rastin e Prokurorisë së Përgjithshme për gjendjen e kriminalitetit dhe në raport me rekomandimet që jep Këshilli i Ministrave për politikën penale që ka të bëjë me gjendjen e kriminalitetit.

Komponenti i tretë janë problematikat. Edhe këtu te rasti juaj, që jeni shumë e kujdesshme, për hir të së vërtetës, si askush nga ne së paku në vlerësimin tim, shikoj se nuk e dallon dot ku është problematika dhe ku është vlerësimi pozitiv. Diku thuhet, tek e njëjta pikë: "Është rritur", diku tjetër thuhet: "Në nivele të ulëta" e të tjera.

Komponenti i katërt janë rekomandimet. Rekomandimet janë të të dyja niveleve. Janë të natyrës orientuese dhe të natyrës së detyrave konkrete. Po ta shikojmë nga kjo pikëpamje besoj se te pjesa e rekomandimeve duke dashur të bëj ndonjë sugjerim, duhet të

hiqen shifrat, sepse ka shumë shifra. Jo të gjitha, ju e dini vetë, së bashku me drejtorinë përkatëse që është marrë me këtë gjë, ndoshta është shumë e ngarkuar, por nuk ka rëndësi.

Përtej kësaj unë dua të ndalem te pjesa që ka të bëjë me rekomandimet. Çështja themelore ku duhet të fokusohet rezoluta e këtij viti ka të bëjë me zbatimin, qasjen, sjelljen, efektshmërinë e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese të ligjit “Për Prokurorinë e Përgjithshme” dhe të Kodit të Procedurës Penale dhe efektin që ato kanë pasur në fushën e luftës kundër kriminalitetit.

Ky është fokusi ynë. Ne kemi bërë një reformë, kemi ndryshuar Kushtetutën, kemi ndryshuar Kodin e Procedurës Penale, kemi ndryshuar ligjin “Për prokurorinë”, kemi ridimensionuar, ripërcaktuar, ripozicionuar rolin e prokurorit e të tjera. Është momenti për të bërë një vlerësim. Ka afërsisht gati një vit dhe ne duhet të bëjmë një vlerësim se cili ka qenë efekti, cili ka qenë impakti dhe çfarë duhet parë.

Unë lexova procesverbalin e mbledhjes së komisionit dhe vërejtja që disa herë Prokurorja e Përgjithshme në detyrë kujdesej të thoshte se kjo nuk është përgjegjësia ime, kjo nuk është detyra ime. Është e vërtetë dhe askush nuk ia ka kërkuar, por ama, nga ana tjetër, ajo ka detyrë të mirëpërcaktuar se si duhet që përmes akteve me natyrë të përgjithshme, të rregullojë këtë marrëdhënie të prokurorëve në raport me këto ndryshime të reja kushtetuese.

Këtu ka dy aspekte:

Së pari, ajo ka detyrimin e nxjerrjes së udhëzimeve të qarta.

Së dyti, bashkëpunimin dhe koordinimin me organet përgjegjëse, siç është rasti i KLP-së apo struktura të tjera që merren me këtë gjë.

Nga ana tjetër është momenti që ne, kur bëjmë një rezolutë, nuk i drejtohem asaj zonjës atje apo zotërisë që mund të ishte në atë karrige, por u drejtohem prokurorit dhe institucionit, që do të thotë se, nëpërmjet kësaj rezolute, duam të kemi disa mesazhe që duhen mbajtur në vëmendje nga prokurorët, se kanë të bëjnë me sjelljen e tyre. Këto duhej të ishin standarde vlerësimi nga KLP-ja dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Ne kemi sot Këshillin që bën vlerësimin, i cili do të duhet t’i vlerësojë prokurorët jo sepse i ka vlerësuar apo jo Prokurorja e Përgjithshme ata për hetime proaktive. Unë e lexova në raport, ku prokuroja thoshte se nuk u imponohej atyre, por udhëzimet tuaja u vetimponohen atyre dhe janë kritere vlerësimi për performancën e tyre dhe duhet t’i orientojmë, se kjo është detyra jonë.

Te pika 7 ju thoni: “hartimin e një kalendar”. Gjëja e parë është zbatimi i ligjit, që sapo u miratua për oficerët e Policisë Gjyqësore. Ata duhet të zbatojnë ligjin, se shoh se nuk po e zbatojnë ligjin që miratoi Kuvendi, pastaj të bëjnë kalendarin.

Trajnimet janë të rëndësishme edhe për prokurorët, edhe për oficerët e Policisë Gjyqësore. Shumë mirë që rezoluta do ta rritet kështu aspekti, por çështja themelore ka të bëjë me zbatimin dhe nevojën për koordinimin me strukturat e tjera, sepse ligji kështu është paraparë, në mos gaboj, edhe nga pikëpamja e funksionalitetit të tij.

Po marr disa çështje të tjera. Bie dakord dhe dëshiroj ta mbështes idenë e kolegut Fino për çështjen e sekretit hetimor. Këtu nuk është çështja vetëm për ta thënë, këtu është për të ndërhyrë, sepse ky u bë rregull. Me gjithë respektin që kam për njerëzit e medias, disa prej tyre dëshirojnë ta quajnë veten “investigator”, por ka ndër ta që e meritojnë këtë post, por, nga ana tjetër, është absurde të dëgjosh në televizor, drejtpërdrejt, se po pres të më thotë prokurori se çfarë ka dalë nga kjo çështje. Është absurde. Vetëm në vendin tonë mund të ndodhë kjo gjë. Gazetari është duke bërë detyrën e vet, respekt për gazetarin, s’kam gjë, por e kam me prokurorin, e kam me prokurorinë.

Vazhdojmë të çështja e hetimeve proaktive. Ne duhet të pranojmë se hetimet proaktive janë pika e dobët e prokurorisë. Duhet ta themi dhe s’kemi asnjë arsye pse mos ta themi.

Është e vërtetë që ne nuk ndërhyjmë të çështjet, por ne orientojmë. Kjo do të thotë se ka disa çështje që janë prioritet për prokurorinë, çështje sensitive me interes të lartë publik. Pse i zvarrit prokuroria? Prokuroria duhet ta ndajë. Ka një shqetësim, ka një tension që shpeshherë bëhet shkak për të rritur artificialisht konfliktin politik apo social, prandaj nuk duhet që çështje të caktuara të zvarriten pa fund.

Kjo është një gjë shumë konkrete. Ka disa çështje sensitive që janë zvarritur apo keqpërdorur në vite dhe vazhdojnë të keqpërdoren për shkak të paaftësisë së prokurorëve të veçantë dhe institucionit në tërësi.

Për bashkëpunimin ndërkombëtar unë nuk bie shumë dakord me vlerësimin që i bëjmë ne, që është një vlerësim pozitiv. Është e vërtetë që ka përmirësim. Prokuroria gjatë vitit të kaluar në raport me prokurorinë e mëparshme ka ndryshime rrënjësore edhe në këtë aspekt, si në shumë aspekte të tjera për shkak edhe të frymëmarrjes që kanë vetë prokurorët dhe lirisë që u jep ligji për të vepruar. Por, nga ana tjetër, duhet të vlerësojmë faktin që sot kemi një tension ose një vëmendje të shtuar lidhur me akuza të ndryshme për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri dhe përdorimin e shqiptarëve si gjenerues të niveleve të larta të kriminalitetit në vendet e tjera.

Prokuroria nuk mund të rrijë inaktive se është përgjegjëse, qoftë edhe për të pasur një rol proaktiv bashkëpunimi edhe për t’i sqaruar këto gjëra. Nuk mund të thuhet se kjo është

çështje vetëm e qeverisë, nuk është kjo çështje vetëm e politikës. Pikësëpari është çështje e tyre.

E fundit që dua të them është çështja që ka të bëjë me transparencën. Këtu ka diçka, por është momenti që krahas informimit të publikut, të flitet për më shumë transparencë nga institucioni i prokurorisë në të gjitha nivelet. Ka një çështje ose ndodh një ngjarje e rëndë, e cila është duke u hetuar, askush nuk e pengon drejtuesin e çështjes të dalë para publikut dhe ta informojë, natyrisht brenda kufijve që njeh ligji, por ta informojë ai publikun, jo thashethemet e pazarit. Ky është detyrim. Ne e kemi theksuar edhe në ligjin e ri, ku ka një rregullim të posaçëm dhe kemi qenë të ndërgjegjshëm gjatë procesit të hartimit të reformës në drejtësi për këtë aspekt, për prokuroritë dhe për gjykatat, sepse është detyrim ndaj qytetarëve, ndaj interesave dhe imazhit të vendit. Nuk duhet të dalë vetëm policia ta bëjë këtë gjë, por duhet të dalë edhe prokuroria, ose të dalin të dy bashkë për ta sqaruar opinion publik, që kjo ngjarje ka këtë impakt, ka këtë problem dhe ne po bëjmë këtë gjë. Edhe pak disa kohësh të dalin dhe të raportojnë dhe të thonë se ne jemi në këtë fazë të procesit. Kur del çështja në gjyq, del prokurori, se mbron punën e vet, s'ka asgjë të keqe. Kjo është një gjë që ndodh kudo, në vendet me standarde shumë të larta, sepse e konsiderojnë detyrim ndaj qytetarëve, ndaj publikut.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Braho!

Spartak Braho – Në vija të përgjithshme edhe unë jam dakord me rezolutën, por bashkohem plotësisht edhe me vërejtjet që bëri zoti Xhafaj. Ne duhet ta rishohim me kujdes formulimin e rezolutës. Pas këtyre vërejtjeve na del për detyrë të bëjmë korrigjime themelore, qoftë edhe ato që kolegu i quajti “në parim”, të cilat unë i konsideroj të drejta, ndaj do t'i lutesha relatores që t'i ketë parasysht.

Unë do të ndalem posaçërisht te pika 15, për të cilën zoti Fino më parë, por edhe tani ka sugjeruar një qëndrim të veçantë. Ruajtja e sekretit hetimor ka të bëjë tërësisht me suksesin e përfundimit të procesit hetimor dhe dërgimin e çështjes në gjyq. Sekretit hetimor është art më vete, se në qoftë se shfryn diçka, ikën edhe procesi nga dora, se këto gjëra ndodhin këtu te ne për motive politike. Ne kemi prokurorë të politizuar, të cilët i përdorin informacionet e marra nga hetimi edhe për të goditur krahun tjetër. Kjo nuk ndodh në Itali. Gjykoj se nuk është i mjaftueshëm hartimi dhe nxjerrja e rregullave për informimin e publikut.

Duhet manual i posaçëm për rregullat e komunikimit të çështjeve hetimore me publikun. Nuk kanë faj gazetarët se atë detyrë kanë, të gërmojnë, pavarësisht se një pjesë e tyre

janë kthyer në llafazanë dhe i bëjnë gjërat e mbaruara. Procesi hetimor ka të penduar, ka bashkëpunëtorë, të cilët duhen mbrojtur deri në fund, sepse shohim se akoma pa përfunduar hetimi, kërcet koburja, vritet një dëshmitar apo diçka tjetër. Prandaj duhet pasur kujdes që pika 15 të formulohet në mënyrë më konkrete, më nominale, më detyruese, me qëllim që të garantojë përgjegjësinë e çdo punonjësi të prokurorisë për ruajtjen e sekretit hetimor.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit të gjithë kolegëve për komentet dhe sugjerimet!

Është e vërtetë që kjo projektrezolutë ka një strukturë tjetër, sepse ndryshe nga rezolutat e mëparshme, unë jam kujdesur të gjejnë pasqyrim shqetësimit që ngriti zoti Xhafaj.

Pjesa e parë, gjendja e kriminalitetit në vitin 2018 kërkesë e nenit 103-104 të ligjit për organizmin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë dhe raportimi në Kuvend.

E dyta, një bllok më vete është konstatimi lidhur me zbatimin e rekomandimeve që Këshilli i Ministrave i kishte lënë Prokurorisë së Përgjithshme në vitin 2018.

E treta, një bllok i veçantë ose një nënseksion lidhur me zbatimin rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Së fundi, është ndërlidhja midis raportit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Drejtësisë.

Lidhur me fekondimin që bën kolegu Xhafaj për shifrat, mendoj se mund të reduktohen, por, meqenëse ka një pikë të veçantë në ligjin për prokurorinë, ku thuhet që raportin për procedimet, për numrin e veprave, për subjektet, për dënimet. Unë mora një për një të gjitha kërkesat e pikave “a” dhe “b” në paragrafin e parë të këtij neni për t’i dhënë një përgjigje. Megjithatë, mund të rregullohet dhe mund të hiqet një pjesë e shifrave, duke folur për trendin.

E gjej me vend shqetësimin që ngritën kolegët Fino, Mara, Braho dhe Xhafaj lidhur me nenin 15. Në fakt, neni 15 ka dy rekomandime brenda.

E para, i rekomandohet hartimi i një udhëzuesi për rregullat se si do të informohet publiku lidhur me hetimet dhe ndjekjet penale në nivel të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Këtu do të ketë patjetër një udhëzues me karakter të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm, sepse në çdo prokurori ka një prokuror të ngarkuar për komunikimet me publikun.

Pjesa e dytë ka të bëjë me nxjerrjen e sekretit hetimor.

Unë nuk bie dakord me rekomandimin ose sugjerimin që u bë këtu për të parashikuar se çfarë përgjegjësie kanë prokurorët. E thotë Kodi i Procedurës Penale, që kur del sekreti hetimor ka ndjekje penale. Pra, nuk kemi pse t'i vëmë një rekomandim e t'i themi prokurorit të zbatojë Kodin e Procedurës Penal

Lidhur me sugjerimin tjetër që bëri zoti Xhafaj për hetimet proaktive, në fakt, te konstatimet unë kam bashkuar problematikën, shkallën e zbatimit të rekomandimit të Këshillit të Ministrave të Kuvendit dhe konstatimin se çfarë është gjetur në vend.

Në fakt, thuhet se hetimet proaktive janë në nivel jo të kënaqshëm, sepse thuhet se ka ende të nevojë të rritet numri i tyre dhe të forcohet cilësia. Për të qenë më të qartë dhe për të përmbushur edhe sugjerimet e kolegëve, mund të bëjnë një ndarje ku të themi se është ulur, nuk është në nivelin e duhur ose është rritur, ose nuk është në nivelin e kënaqshëm e kështu me radhë.

Lidhur me Policinë Gjyqësore, unë besoj (nuk ndaj të njëjtin mendim me kolegun Xhafaj) se ne nuk mund t'u themi prokurorëve që të zbatojnë ligjin. Zbatimi i ligjit është detyrim, një nga problemet e konstatuara në raport dhe gjatë raportimeve që janë bërë, është që oficerët e PGJ-së duhet të trajnohen për institutet e reja që parashikon Kodi i Procedurës Penale dhe për detyrat e reja që i ka dhënë Kodi dhe ligji "Për organizmin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

Shqetësimin që ngriti zoti Xhafaj do ta reflektoj jo duke shtuar rekomandim, por duke riformuluar fjalinë përkatëse kur flitet për zbatimin e drejtë të ligjit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të oficerëve të PGJ-së.

Këtu u ngrit një shqetësim lidhur me bashkëpunim. Është thënë që bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është në nivelet e duhura dhe ka nevojë të rritet ky bashkëpunim.

Deklarata do të redaktohet nga ana e teknikës legjislative, duke pasqyruar edhe shqetësimet që ngrit zoti Hyseni. Njëkohësisht, e gjej me shumë vend rekomandimin e zotit Hyseni për të shtuar një pikë më vete për zbatimin e rekomandimeve të komisionit ad-hoc që funksionon pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në fakt, zoti Xhafaj ngriti një problem që ia vlen ta diskutojmë, zoti kryetar.

Në ligjin "Për prokurorinë, prokurori raporton për gjendjen e kriminalitetit. Kjo është. Gjendja e kriminalitetit kushtëzohet jo vetëm nga masat që merr organi i prokurorisë, por edhe nga bashkëpunimi i këtij organi me institucionet e tjera. Prandaj, ka disa rekomandime, të cilat lidhen me nevojën e organizimit të funksionimit më të mirë të prokurorisë, si dhe bashkërendimit të punës me institucionet e tjera, gjë që është çelësi i suksesit për uljen

kriminalitetit. Megjithatë, titulli i projektrezolutës nuk është projektrezolutë në vlerësimin e gjendjes së kriminalitetit për vitin 2018, po “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2018.”

Besoj se kështu ka qenë në gjithë historinë e rezolutave që ka bërë Kuvendi i Shqipërisë, ndërkohë që historikisht, prokurori raporton në lidhje me gjendjen e kriminalitetit.

Pra, ne nuk mund të themi: “Rezolutë për vlerësimin e gjendjes së kriminalitetit”, sepse këtu hyn policia, hyn gjykata, hyjnë edhe institucionet e tjera jopenale, por: “Veprimtaria e prokurorit në lidhje me parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit”. Në këtë kuadër, mbase në të ardhmen do të shikojmë se si mund të unifikohen dhe standardizohen rezolutat për prokurorinë, meqenëse do të raportojë edhe SPAK-u. Ne kemi të drejtë të thërrasim edhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. Në këtë kuadër ia vlen, sepse do të jetë diskutim më profesional, më i detajuar lidhur me një adresim më të drejtë të shqetësimit që ngriti kolegu Xhafaj.

Në fund, të nderuar kolegë, meqenëse kolegu Xhafaj, por edhe juve, e përmendët disa herë se theksi duhet vënë te zbatimi i reformës në drejtësi, ka disa rekomandime, siç janë rekomandimet 13, 14, rekomandimet 5, 6, si dhe rekomandimi 4, të cilët lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e reformës në drejtësi.

Nëse ju jeni dakord, ne mund t’i rendisim ndër të parat, duke i theksuar qartë, pra të bëjmë një rigrupim, një risistemim të paragrafëve, për të dalë roli i prokurorisë në zbatimin e reformës në drejtësi, duke renditur të pesë rekomandimet që janë. E dyta, në fushën e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit, me partnerët. E treta, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë të miturit dhe viktimat. E katërta, lidhur me oficerët e Policisë Gjyqësore, dhe zbatimin e rregullave në hetimet proaktive, me luftën kundër trafikut.

Pra, ekziston gjithë mundësia, dhe duhet më pak se gjysmë ore për t’i sistemuar, për t’i unifikuar dhe për të qenë të qartë në lidhje me të gjitha shqetësimet që ngriti kolegu Xhafaj dhe kolegët e tjerë.

Faleminderit shumë për kontributin!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Ka sugjerime e komente nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

Në fakt, unë e kam lexuar me vëmendje tekstin e projektrezolutës, dhe dua ta falënderoj kolegen Hysi për seriozitetin me të cilin me të cilin e ka punuar këtë projektrezolutë, së bashku edhe me Shërbimet e Kuvendit. Po ashtu, e vlerësoj jashtë mase edhe nivelin e përfshirjes së kolegëve me komente e sugjerime, në lidhje me tekstin e projektrezolutës.

E para, Kuvendi e ka standardizuar manualin e raportimit të institucioneve kushtetuese e të pavarura, dhe ka një manual të miratuar me vendim të Kuvendit, lidhur me manualin e raportimit. Pse jo, jam plotësisht dakord që të kemi edhe një standardizim të teksteve të projektrezolutave, për të gjitha institucionet kushtetuese e të pavarura që raportojnë në Kuvend, lidhur me ato tre pjesët që duhet të ketë një rezolutë: vlerësimin e veprimtarisë së institucionit; zbatimin e rekomandimeve të lëna nga rezoluta paraardhëse. Si pjesë e fundit, të jenë edhe rekomandimet për vitin në vazhdim.

Edhe unë kam nja dy a tri gjëra në lidhje me tekstin e projektrezolutës. Në pikën 6, më tepër e kam si theksim të karakterit të teknikës legislative: bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, dhe jo me Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Kam edhe një sugjerim për pikën 12, po para se të vi te sugjerimi për pikën 12, unë bie dakord me të gjithë kolegët, që Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvend, sipas ligjeve të reja të reformës, në lidhje me gjendjen e kriminalitetit. Këtu bëhet fjalë për veprimtarinë e institucionit të prokurorisë dhe jo të Prokurorit të Përgjithshëm, cilido që të jetë, ky që është në detyrë apo tjetri që do të vijë.

Raportimi i Prokurorit të Përgjithshëm, sipas ligjit për prokurorinë, është një sintezë e punës hetimore njëvjeçare të të gjitha prokurorive vendore.

Unë mendoj se rezoluta e Kuvendit do të duhet të përçojë mesazh të fortë në drejtim të asaj çka ne kemi parashikuar në ndryshimet kushtetuese dhe në ligjin e ri “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”: garantimin e pavarësisë së prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale e të hetimit, si dhe rritjen e rolit të prokurorit të çështjes si lider i hetimit.

Në këtë pikë duhet të fokusohet Kuvendi, që të japë gjithë mbështetjen e duhur për institucionin e prokurorisë.

Lidhur me detyrat që ligji i ngarkon Prokurorit të Përgjithshëm, patjetër që do të duhet të gjejnë vend në tekstin e projektrezolutës.

Çështja e statistikave, çështja e bashkëpunimit me të tretët, por edhe me autoritetet e huaja, çështja e marrjes në konsideratë të rekomandimeve që bën komisioni *ad hoc* i Kuvendit në këtë fazë ku jemi, patjetër që janë detyra, të cilat lidhen drejtpërdrejt me rolin e Prokurorit të Përgjithshëm, e atij në detyrë apo e atij që do të vijë. Janë detyra funksionale, të cilat burojnë drejtpërdrejt nga ligji.

Me të drejtë, kolegët këtu ngritën shqetësimin e pikës 15, që në tekstin e projektrezolutës duket se ka të bëjë me nxjerrjen e sekretit hetimor.

Të nderuar kolegë, nxjerrja e sekretit hetimor është vepër penale. Absolutisht që është vepër penale, që dënohet nga Kodi Penal.

Tani, për të gjitha këto shqetësime që dalin në tekstin e projektrezolutës e që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organit të prokurorisë, në raport me detyrimet që burojnë nga Kodi i procedurës Penale, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj, kolegë, se Prokurori i Përgjithshëm ka vetëm një instrument ligjor në dorë: udhëzimet me karakter të përgjithshëm.

Edhe për sa i përket pikës 12 të tekstit të projektrezolutës, ku unë kisha një sugjerim konkret, sugjerohet përdorimi efektiv në funksion të shpejtësisë së procesit dhe qëllimit të ligjit penal të instituteve procedurale të reja, si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë e të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht që kjo duhet të bëhet nëpërmjet një udhëzimi me karakter të përgjithshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të më duhet të dal në fillim, sepse në formulimin që ka pika 12, krijohet ideja sikur Prokurori i Përgjithshëm mund të urdhërojë prokuroritë poshtë, për aplikimin e parashikimeve të reja që ka Kodi i Procedurës Penale. Jo. Prokurori i Përgjithshëm mund ta bëjë këtë vetëm nëpërmjet një udhëzimi me karakter të përgjithshëm, sepse kjo pikë ka të bëjë drejtpërdrejt me garantimin e pavarësisë së prokurorit të hetimit, si zot i hetimit.

Edhe në lidhje me nxjerrjen e sekretit hetimor ka një udhëzim me karakter të përgjithshëm, të dalë nga Prokurori i Përgjithshëm. Është publike në faqen e prokurorisë, gjë që u tha edhe në raportim, se ka një udhëzim të dalë për këtë qëllim nga shqetësimet që kanë lindur kohët e fundit, por theksin do të duhet ta vëmë në zbatimin e këtij udhëzimi. Pra, siç sugjeron me të drejtë kolegja Xhina, theksin do të duhet ta vëmë në ndjekjen e këtij udhëzimi. Pastaj, kjo lidhet edhe me pikën 15, që ndjekja e këtij udhëzimi në mënyrë rigoroze do të bëjë që nxjerrja e sekretit hetimor të trajtohet realisht siç është vepër penale në Kodin Penal.

Patjetër që janë edhe shqetësimet e ngritura në lidhje me Policinë Gjyqësore. Patjetër që Policia Gjyqësore është një hallkë shumë e rëndësishme në zinxhirin e hetimit penal. Madje mund të themi se një Polici Gjyqësore cilësore garanton cilësinë e procesit të hetimit e të ndjekjes penale dhe është shumë e nevojshme. Nuk e di nëse ligji “Për Policinë Gjyqësore” ka hyrë në fuqi, por duhet të ketë hyrë.

Teksti i projektrezolutës duhet të ketë një parashikim, ku t’i kërkohet Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të atij ligji, sepse siç e dimë, në zbatim të atij ligji do të duhet të dalin disa akte nënligjore. Ne kemi përcaktuar një kohë prej gjashtë muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit, në mënyrë

që ligji i ri të implementohen plotësisht, dhe ne të kemi atë Polici Gjyqësore që presim, një Polici Gjyqësore profesionale, pse jo e mirëtrajnuar edhe në drejtim të metodave speciale të hetimit, të cilat gjithsesi garantojnë sukses.

Unë nuk e di, kolegja Hysi, nëse është e mundur të adresohen disa nga sugjerimet në tekstin e projektrezolutës, duke përfshirë edhe një riformulim të pikës 15, ndoshta një riformulim të pikës 12, me karakter të teknikës legjislative, por edhe ato që bënë kolegët Hyseni, Xhafaj e të tjerë, që u përfshinë në këtë diskutim. Nëse ne biem dakord ta votojmë tekstin e projektrezolutës, duke i reflektuar të gjitha këto sugjerime që u bënë nga kolegët, unë personalisht jam dakord. Le ta hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi, pasi flet kryetari i komisionit, në fakt...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Adriatik Alimadhi – Këtu te statistikën, 64, 34 % e të pandehurve janë të papunë. Tashti, ne si Komision i Ligjeve, ku duhet t'i sugjerojmë politikën? Është një statistikë shumë e madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, po çfarë konkretisht?

Ulsi Manja – Jo, mund të gjendet një mënyrë formulimi, që edhe institucionet e tjera... Pra, kur flasim për bashkëpunimin e prokurorisë me të tretët, mund të sugjerohet, të adresohet, të mbahet në konsideratë edhe gjendja shoqërore e personave që janë nën hetim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, ta përmbyll. Pastaj mund ta merrni fjalën në lidhje me ecurinë, sipas Rregullores.

Zonja Hysi, biem dakord?

Vasilika Hysi – Vetëm për një gjë nuk bie dakord.

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Të gjitha shqetësimet e kolegëve janë në rezolutë. E vetmja gjë, sikurse e thashë. Ju flisnit, dhe unë bëja kontrollin një për një. Janë që të tëra. Në qoftë se biem dakord që rekomandimet e zotit Xhafaj për të evidentuar rolin e prokurorit në zbatimin e ligjeve të reformës në drejtësi, duke filluar që nga pavarësia, që parashikohet në pikën 14, ndërsa rekomandimi 13 të kalojë në fillim; po ashtu, të ritheksohet ai rekomandim që bëri kryetari i komisionit, miratimin e udhëzimeve ta nxjerrim si fjalë kyçe në çdo paragraf, atëherë unë jam

dakord. Unë nuk jam dakord vetëm me rekomandimin tuaj të fundit, kur thatë: “T’i rekomandojmë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore.”

Kjo rezolutë nuk është për Këshillin e Lartë të prokurorisë, se ata do të raportojnë më vete.

Ulsi Manja – Të lutem! Dakord, dakord, nuk po them që të përfshihet në mënyrë eksplicite, që ne t’i japim në...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të lutem!

Rezoluta është për prokurorin, për institucionin e prokurorisë, por nëse ligji “Për Policinë Gjyqësore” e involvon edhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, që të përfshihet në nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit “Për Policinë Gjyqësore”... Unë nuk po them të ndërhyjmë e të cenojmë pavarësinë e atij institucioni, po për sa i takon Prokurorit të Përgjithshëm, do të duhet të theksohet. Ajo që i takon Prokurorit të Përgjithshëm do të duhet të theksohet.

Tani, jemi dakord?

Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Për ta ndihmuar zonjën Hysi, sepse ka punuar dhe ka bërë një rezolutë shumë të mirë. Në lidhje me strukturën e foli zoti Xhafaj shumë mirë. Aty janë elementët e vlerësimit, konstatimit, problematikës. Kur vjen puna te rezolutat, ato duhet të ndahen në orientuese dhe në detyra konkrete.

Ndaji këto orientueset në fillim, detyrat konkrete më pas, dhe vetvetiu e merr formën dhe vlerën e gjithë projektrezoluta. Thjesht të rregullohen këto, dhe ne do ta votojmë në parim pa problem.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe unë bashkohem me sugjerimin e kolegut Fino.

Ta votojmë në parim tekstin e projektrezolutës, me të gjitha ato sugjerime, për të cilat ramë dakord që të përfshihen në tekstin e projektrezolutës. Më pas, rezoluta t’u shpërndahet kolegëve deputetë nëpërmjet postës elektronike. Gjithmonë, para votimit në seancë plenare, ne do të kemi mundësinë të shohim edhe një herë, nëse kanë gjetur reflektim të gjitha sugjerimet për të cilat ramë dakord.

Kush është dakord me tekstin e projektrezolutës?

Pro? Kundër? 2 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet teksti i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2018”, me sugjerimet që u dakordësuan në komision.

Shumë faleminderit!

Këtu e mbyllim pjesën e parë të mbledhjes së komisionit. Mbledhjen tjetër do ta zhvillojmë rreth orës 13.

MBYLLET MBLEDHJA